



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:105610

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05429966

**NË EMËR TË POPULLIT**

**P.nr.283/2019**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Xhemajl JUSUFI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në lëndën penale ndaj të pandehurit L...M.... për shkak të veprës penale: Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 paragrafi 1 të Kodi Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: *KPRK*), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.881/2019, të datës 08.03.2019 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e ka ri kualifikuar veprën penale ndaj të pandehurit L...M.... në veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 4 dhe 6 të Kodi Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: *KPRK*), shqyrtimi gjyqësor është mbajtur me datë 08.02.2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Arjan Xhema, i pandehuri L...M...., mbrojtësi i tij sipas autorizimit, avokat Armend Shkoza, dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës, V....L....., me datë 12.02.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 07.03.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri:

L...M...., nga i ati F..., e ëma S...., e vajzërisë B...., i lindur më datë 11.10.1983, në Mitrovicë, ku edhe tani jeton në “Sh.... A... J....”, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, bashkëpronar në firmën “M.... S....”, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

Prej datës së pa vërtetuar e deri me datë 02.05.2018, në Mitrovicë në lokalitetin e vet, “M... S...” SHPK, me qëllim që vetit t’i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike ashtu që nuk e ka prezantuar njehsorin elektrik me nr. ...., përmes të cilit është furnizuar me energji elektrike, me qëllim të shmangies së pagesës së energjisë së shpenzuar elektrike dhe ka shpenzuar energji elektrike pa matje, me çka i ka shkaktuar dëm KEDS-it në vlerë prej 3,697.49 euro.

**Me këtë ka kryer veprën penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 4 dhe 6 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 37, 39, 43, 69, 70 dhe 314 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 4 dhe 6 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, e:

## G J Y K O N

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 1500 euro (*me fjalë: njëmijë e pesëqind euro*), të cilin dënim është i obliguar që t' a paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet me 20 (njëzetë)euro.
- II. Obligohet i akuzuari, t'ia kompensoj dëmin palës së dëmtuar KEDS në Mitrovicë, në shumë prej 3,697.49 euro (*me fjalë: tremijë e gjashtëqind e nëntëdhjete e shtatë euro, e dyzetë e nëntë cent*), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- III. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.881/2019 të datës 08.03.2019, kundër të pandehurit L...M.... për shkak të veprës penale: Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor me datë 02.09.2020, 06.11.2020, 13.11.2023, dhe 08.02.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Arjan Xhema, i pandehuri L...M...., mbrojtësi i tij sipas autorizimit, avokat Armend Shkoza dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës, V....L..... Në shqyrtim gjyqësor, i pandehuri është deklaruar i pafajshëm për veprën penale që i vihej në barrë, ndërsa gjykata ka dëgjuar dëshmitarët, R.... M..., G.... P..., R... F...., ka administruar provat materiale dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve.

### *Fjala përfundimtare e palëve:*

Në fjalën përfundimtare, prokurori i shtetit ka deklaruar se mbetet pranë aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.881/2019 ndaj të pandehurit L...M.... në drejtim të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, e cila u vërtetua nga provat të cilat janë administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, prova të cilat e vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë se jo vetëm se është kryer vepra penale por edhe se i pandehuri është kryerës i kësaj vepre, andaj nga të gjitha të lartcekurat më lartë i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit duke i marr parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe po ashtu që të njëjtin ta obligoj të ia kompensoj dëmin të dëmtuarës KEDS në shumën e cekur si në dispozitivin e aktakuzës.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës, V...L..., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: mbetet pranë deklaramëve të thëna në fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit, gjithashtu si palë e dëmtuar ka kërkuar nga gjykata që me rastin e administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës të pandehurin ta shpall fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë, pasi që të gjitha provat që janë propozuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, të njëjtat pasqyrojnë në mënyrë të drejtë dhe të qartë se i njëjti KEDS-it i ka shkaktuar dëmin në vlerë prej 3,697.49 euro, dhe ka kërkuar nga gjykata që të obligoj të pandehurin të kompensoj dëmin e shkaktuar kopanisë KEDS dhe të njëjtën ta shpall fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Mbrojtësi i të pandehurit L...M..., avokat Armend Shkoza në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: fjalën përfundimtare e dorëzon me shkrim në format A4, gjithsejtë tri faqe dhe të njëjtën e ka elaboruar, në të cilën ndër të tjera ka theksuar se edhe nga provat që janë propozuar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se asnjë nga provat e po ashtu edhe nga deklaramet e dëshmitarëve, respektivisht dëgjimi i tyre në këtë çështje penale, nuk është arritur që të provohet së i mbrojturi i tij të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Tutje, ka theksuar se nga provat e propozuara nga mbrojtja shihet qartë se Prokuroria Themelore në Mitrovicë nuk ka zbatuar ligjin në fuqi e po ashtu edhe ligjin për përgjegjësinë penale të personave juridik duke pas parasysh se i mbrojturi i tij si bashkëpronar i M.... S... Sh.P.K, në mënyrë të paragjykuar është përfshirë në këtë çështje penale pas asnjë provë të vetme apo dëshmi të dëgjuar deri me tani. Andaj nga të gjitha këto i ka propozuar gjykatës në mbështetje të nenit 363 par.1 nën par 1.3 të KPP-së, meqenëse nuk është provuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe kjo Gjykatë të merr aktgjykim lirues ndaj të pandehurit.

I pandehuri në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se e mbështetë fjalën e mbrojtësit dhe nuk ka shtuar asgjë.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtura me datë 02.09.2020, 06.11.2020, 13.11.2023, dhe 08.02.2024, gjykata ka dëgjuar dëshmitarët R... M..., G... P..., dhe R.... F....

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 02.09.2020, gjykata ka dëgjuar dëshmitarin R... M..., i cili ndër të tjera ka theksuar se atë ditë kur ka ndodhur rasti kanë shkuar në vendin e ngjarjes në bazë të udhëzimit dhe procesverbalit të cilin e kanë pranuar nga grupi matës, kur janë shkuar nuk ka pasur matës elektrik dhe në bazë të procesverbalit kanë vendosur matës elektrik në lokal. Më tej ka shtuar se trafo gjendet afër marketit “E....”, pas vendosjes së matësit të ri elektrik, i njëjti nuk është gjendur, kanë shkuar deri te restoranti i cili gjendet në rrethin e “E....”, sepse kanë pasur informata se këtë njësor është duke e përdorur ky restorant, kanë bërë regjistrimin e të gjithë njësorëve elektrik të cilët ishin prezent në atë restorant dhe aty kanë hasur në një person i cili ka qenë përgjegjës i restorantit, të cilit nuk ia din emrin, por vetëm informacion se këtë restorant e ka mbajtur M..., ndërsa emrin e pronarit nuk e kanë pasur. Me tej ka shtuar se në ditën kritike nuk ka pasur njehsor, dhe shihen gjurmët se aty ka qenë i vendosur një njehsor, kanë qenë gjurmë në tabelë, sepse tabela ka qenë e shpuar dhe po ashtu nuk ka dijeni se ku është ai njehsor dhe M.... S.... ka qenë i kyçur përmes kabllos në njehsor matës të E...., se pas çkyqjes, është çkyqur edhe komplet objekti i E.... nuk ka pasur energji elektrike. Në procesverbal i ka cekur të gjitha veprimet që kanë ndodhur në vendin e ngjarjes që kanë vendosur njehsorin e ri dhe pajisjet dhe po ashtu janë evidentuar edhe njehsorët elektrik të cilët kanë qenë në restorant, nga të cilët kanë mundur të

shpenzojnë energji elektrike në njehsorin e vjetër. Tutje, ka theksuar se nuk e ka hequr kabllon e cila ka qenë e lidhur në E...., por vetëm e kishin vendosur atë njehsor por të mos pësuar humbje të cilat më parë janë shpenzuar. Dëshmitari ka theksuar se ekipi e ka për detyrë kur shkon në trafo të bëjë matjen dhe ta shikon një njehsor të cilin e verifikojnë nëse është i regjistruar dhe në rastin konkret në bazë të procesverbalit të grupit matës të nënshkruar nga persona të cilët janë kompetent për trafon, ka ekzistuar një njehsor i cili gjendet në procesverbal dhe me kilovat të shpenzuar të energjisë elektrike, dyshimi i cili ka qenë se njehsori i cili ka qenë aty është larguar në momentin kur kanë shkuar për verifikim.

Dëshmitari G.... P...., gjatë shqyrtimit gjyqësor me datë 06.11.2020, ne mes të tjerash kishte deklaruar se sipas kërkesës nr..... të KEDS-it, kanë shkuar te E.... për të bërë ndarjen e njehsorëve të ati objekti, në të cilin kanë vendosur njehsor të ri. Tutje, ka theksuar se njehsorin e kanë vendosur në bazë të procesverbalit të vitit 2017, dhe aty nuk ka pasur njehsor por kanë vendosur një të ri, i cili nuk e furnizon askënd dhe deri më sot nuk ka shpenzuar asnjë kilovat, por KEDS-si e ka vendosur në emër të M..... Tutje, nga prokurori i shtetit i ka prezantuar procesverbali me numër ....., i cili ka theksuar se kur kanë shkuar në vendin ngjarjes nuk kanë gjetur asnjë keqpërdorim dhe me urdhëresë nga KEDS-i e kanë vendosur njehsorin e ri në emër te M.... dhe procesverbali po ashtu është përpiluar në emër te M.....

Dëshmitari R.... F..., gjatë shqyrtimit gjyqësor me datë 06.11.2020, ne mes të tjerash kishte deklaruar, se iu është dorëzuar procesverbali me nr....., i vitit 2017, dhe në bazë të këtij procesverbali iu është urdhëruar që të vendosin një njehsor të ri dhe kur kanë shkuar në vendin e ngjarjes nuk ka pasur njehsor të vjetër i cili është furnizuar në të gjithë objektin e E..... Tutje ka theksuar se janë bazuar në procesverbalin paraprak i cili është përpiluar nga persona të tjerë të cilët janë S.... B...., Z.... N... dhe N.... A...., por kur kanë dalur në vendin e ngjarjes, ka pasur edhe parregullsi të tjera. Gjithashtu nder të tjera ka shtuar se gjithmonë shkojnë kur nuk ka njehsor dhe vendosin njehsorin e ri dhe atë në bazë të procesverbalit i cili është përpiluar më herët, sepse fotografi nuk kanë pasur nga njehsori paraprak, ndërsa për njehsorin .... kanë qenë punonjësit të cilët e kanë hupur trafon dhe personi përgjegjës ka qenë personi i E...., i cili ka thënë se nuk është në dijeni lidhur me këtë njehsor dhe konsumatori i cili ka qenë me qira është larguar nga lokali dhe nuk e din për kë bëhet fjalë. Tutje, ka theksuar se në vendin e ngjarjes ka qenë një kabull dhe është furnizuar E....., procesverbalin e të cilës e kemi përpiluar në emër të M.... sepse procesverbali paraprak i vitit 2017 ka qenë i përpiluar në bazë të tij.

#### *Provat e administruara:*

Gjykata, gjatë shqyrtimit gjyqësor, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike administroi provat si në vijim: Ndërmarrja Kosovare me Energji Elektrike. Nr. CMSK/DMI 126/19, e datës 22.02.2019; Procesverbali dhe raporti për ndërrimin ose shmangien dhe largimin e njehsorit elektrik, me numër ....., e datës 02.05.2018; Fatura me numër rendor ....., e datës 02.05.2018; Raporti mbi Kontrollimin – pranimin e vendosjes të njehsorit elektrik të datës 02.05.2018; Raporti mbi Kontrollimin – pranimin e grupit matës, me numër ....., i datës 17.10.2017; Kopja e vërtetimit për kyçje, e datës 05.05.2017, e vërtetuar te Noteri Dukagjin Dinaj; Transaksioni i konsumatorit në emër te ndërmarrjes M..... SH.P.K dhe të dhënat për biznesin M.....S.....

Pas dëgjimit të dëshmitarëve dhe administrimit të provave materiale, i pandehuri nuk ka dhënë mbrojtjen e tij, respektivisht ka shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes në heshtje, ndërsa nuk ka dhënë deklaratë në fazën hetimore.

*Vlerësimi i gjykatës:*

Gjykata, pasi ka administruar provat personale dhe materiale, ka vërtetuara gjendjen faktike si në dispozitiv.

Për gjykatën, nuk ishte kontestuese se i pandehuri, ishte person i autorizuar në kompaninë M.... S...., në pikën e cila gjendej në Rr. “B.... B....” në Mitrovicë, dhe kjo vërtetohet nga të dhënat për këtë biznes, të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese se me datë 17.10.2017, punëtorët e të dëmtuarës KEDS, ishte bërë kontrollimi i grupit matës për matjen e energjisë elektrike tek konsumatori “E.... SH.P.K”, ndërsa siç është konstatuar në këtë procesverbal, pala (E.... SH.P.K) kishte bërë ndarjen e instalimit të restaurantit M....., për të cilin ishte montuar pika matëse e veçantë, dhe kjo vërtetohet nga procesverbali i raportit mbi kontrollimin- pranimin e grupit matës me numër ....., të datës 17.10.2017 dhe dëgjimi i dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor. Në këtë procesverbal është konstatuar se ka qenë i vendosur njehsori elektrik me nr. .... tek konsumatori “M.... S....”, SHPK.

Po ashtu për gjykatën, nuk ishte kontestuese se me datë 02.05.2018, punëtorët e të dëmtuarës KEDS kishin dalë në teren për ndërrimin e njehsorëve elektrik, dhe kjo vërtetohet nga procesverbali i kontrollës dhe dëgjimi i dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor. Në këtë procesverbal (procesverbali me numër ..... i datës 02.05.2018) është konstatuar procesverbali është përpiluar te konsumatori “M.... S....” SHPK, në Mitrovicë. Në këtë procesverbal ishte konstatuar se konsumatori nuk kishte prezantuar njehsorin elektrik të cilin e ka pasur të vendosur përmes procesverbalit të datës 17.10.2017 dhe për këtë, i kanë vendosur njehsorin e ri të KEDS-it.

Gjykata vëren se kontestuese në këtë çështje penale ishte nëse i pandehuri ishte përgjegjës për shfrytëzimin e energjisë elektrike duke mos regjistruar atë energji apo jo.

Lidhur me këtë çështje, gjykata pas administrimit të provave një nga një dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 7 dhe 360 të KPP-së, ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se i pandehuri ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata ka vërtetuar se i pandehuri, prej datës së pa vërtetuar e deri me datë 02.05.2018, në Mitrovicë, në lokalit “M.... S....” të cilën ai e posedonte, pa njehsor elektrik, pa autorizim, ka shfrytëzuar energjinë elektrike duke u kyçur drejtpërdrejtë në rrjetin elektrik, duke i shkaktuar të dëmtuarës KEDS dëm material.

Këtë gjendje faktike, gjykata e ka vërtetuar nga provat materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor, përkatësisht nga Procesverbali me numër ..... të datës 02.05.2018, përmes të cilit është vërtetuar se i njëjti nuk ka prezantuar njehsorin elektrik me nr. ...., i cili njehsor i ishte vendosur me datë 17.10.2017 dhe me urdhëresë të KEDS-it, tek konsumatori “M..... S.....” SH.P.K, me

pronar L...M.... në Mitrovicë, është bërë vendosja e njehsorit të ri. Në këtë procesverbal tutje është konstatuar se konsumatori ka qenë i kyçur pa njehsor.

Pra nga administrimi i kësaj prove materiale, gjykata ka vërtetuar se i pandehuri, me dashje, në kundërshtim me ligjet në fuqi, ka shfrytëzuar energjinë elektrike duke mos pasur njehsor elektrik, duke i shkaktuar kështu të dëmtuarës KEDS dëm material.

Gjykata i ka besuar në tërësi kësaj prove materiale pasi që procesverbali i datës 02.05.2018 është përpiluar nga një organ i autorizuar për distribuim dhe furnizim me energji elektrike në vendin tonë siç është KEDS-i.

Një gjendje të tillë faktike, gjykata e ka vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitarëve R.... M....., G.... P...., dhe R.... F.... e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të cilët kanë deklaruar se në ditën kritike kanë shkuar në vendin e ngjarjes në bazë të udhëzimit dhe procesverbalit të cilin e kanë pranuar nga grupi matës, pra kanë shkuar në baza të procesverbalit të datës 17.10.2017 dhe kur kanë arritur, nuk ka pasur matës elektrik dhe në bazë të procesverbalit kanë vendosur matës elektrik të ri në emër të lokalit “M...”, me pronar L... M.....

Gjykata i ka besuar këtyre deklaratave të dëshmitarëve pasi që të njëjtat janë në përputhje edhe me provat tjera, përkatësisht me procesverbalin numër ..... të datës 02.05.2018 e përpiluar në vendin e ngjarjes nga ana e ekipeve të të dëmtuarës KEDS të cilët kishin shkuar për të vendosur njehsorin elektrik dhe gjithashtu në përputhje të plotë edhe me procesverbalin e me numër ....., të datës 17.10.2017, përmes të cilit ishte konstatuar se restaurantit Missini, i ishte vendosur pikë matëse e re, njehsori ISKRA, me numër .....

Neni 314 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 4 dhe 6 të KPRK-së ka përcaktuar se: *“1. Kushdo që merr, përdor, devijon, nxjerr ose përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.”*, *“4. Për qëllime të këtij neni, “shërbime” përfshinë, por nuk kufizohet në transportimin; punën, shërbimet profesionale, teknike apo mekanike; shërbimet e skiliftit; objektet për biseda telefonikë; gazin, ujin, rrymën apo ngrohjen; shërbimet e komunikimit ose telefonisë; ofrimi i ushqimit apo akomodimit; furnizimi me pajisje, vegla, vetura ose kamp-shtëpiza për përdorim të përkohshëm; furnizimi i pajisjeve për shfrytëzim; ose qasja në sistemin e internetit, kompjuterik apo kabllor. “Shërbim” po ashtu përfshinë çmimin e hyrjes në evenimente sportive, zbavitëse, shfaqje ose ngjarje tjera që kanë çmim të hyrjes ose tarifë tjetër për pjesëmarrje.”*. *“6. Për qëllime të këtij neni, vjedhja e shërbimeve të gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes përfshinë, por nuk kufizohet në marrjen, përdorimin, devijimin, nxjerrjen ose përfitimin nga ndonjë shërbim i gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar”*.

Sa i përket elementeve të përgjithshme të veprës penale, nga provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar përtej çdo dyshimi se i akuzuari, duke shfrytëzuar energjinë elektrike pa njehsor elektrik, pra pa kompensim ndaj institucionit të autorizuar për mbledhjen e këtyre mjeteve në emër të shpenzimit të energjisë elektrike, i ka shkaktuar dëm material të dëmtuarës KEDS.

Gjykata ka vërtetuar elementin subjektiv të kësaj vepre penale, përkatësisht dashjen e të pandehurit për kryerjen e kësaj vepre penale ashtu që i njëjti, duke shfrytëzuar energjinë elektrike pa qenë i kyçur në njehsor elektrik, ka shfrytëzuar pa autorizim energjinë elektrike dhe në këtë mënyrë i është shmangur pagesës së detyrimeve për energjinë elektrike të shfrytëzuar dhe i ka shkaktuar dëm material të dëmtuarës KEDS. Andaj për këtë gjykatë, përtej çdo dyshimi, pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, është vërtetuar se i pandehuri me veprimet e tij, ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 4 dhe 6 të KPRK-së.

Nga administrimi i provave materiale siç janë kalkulimi i rikthimit të humbjeve i të dëmtuarës, i datës 10.05.2018 dhe Fatura me numër ....., e datës 10.05.2018, vërtetohet dëmi i shkaktuar të dëmtuarës, i cili kalkulim është bërë në bazë të pajisjeve të cilat janë gjendur në restaurantin e të pandehurit, të cilat pajisje, konstatohen edhe në procesverbalin e kontrollës të datës 02.05.2018.

Gjykata, në bazë të nenit 3 paragrafi 2 të KPRK-së, ku përcaktohet se: “2. *Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.*”, e ka ri kualifikuar veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të Kodi Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: KPRK) në veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 4 dhe 6 të KPRK-së, meqenëse duke qenë se ky ligj, i cili ka hyrë në fuqi nga data 14.04.2019 është më i favorshëm për të pandehurin në aspektin e dënueshmërisë, pasi që i njëjti, për dallim nga ai paraprak i cili parashihte dënimin në mënyrë kumulative dënimin me gjobë dhe burgim, ligji i ri e parashihet në mënyrë alternative me gjobë ose burgim. Gjykata rikujton se mundësia për ta ndryshuar kualifikimin ligjor të veprës penale nga ajo në aktakuzë, është e lejueshme dhe e paraparë me ligj dhe kjo lejohet sipas nenit 359 paragrafi 2 të KPP-së.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Rrethana rënduese për të pandehurin në këtë çështje penale, nuk gjeti, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e ka vlerësuar sjelljen përgjithësisht korrekte të pandehurit, rrethanat familjare përkatësisht faktin se i njëjti është person familjar.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me gjobë ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t’i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

*Refuzimi i propozimit të përfaqësuesit të dëmtuarës:*

Gjykata, në shqyrtim kryesor, ka refuzuar propozimin e përfaqësuesit të dëmtuarës i cili ka propozuar që të dëgjohen punëtorët e KEDS-it nga departamenti i matjeve, Zymer Nimani dhe

Naim Ahmeti, me arsyetimin se në bazë të procesverbalit që ata e kanë referuar me numër ....., të datës 17.10.201, të njëjtit kanë bërë montimin dhe vendosjen e këtij njehsori në lokalin M.... S.....

Gjykata e ka refuzuar propozimin e mbrojtjes me arsyetimin se nuk është kontestuese se njehsori ka qenë i vendosur te konsumatori “M...”, me numër ....., i cili fakt vërtetohet përmes raportit mbi kontrollimin-pranimin e grupit matës me numër ..... të datës 17.10.2017, po ashtu edhe që nuk është prezantuar njehsori vërtetohet nga procesverbali i përpiluar nga punëtorët e të dëmtuarës me numër ..... të datës 02.05.2018, andaj edhe ka vendosur për refuzimin e propozimit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për obligimin e të pandehurit për t’ia kompensuar dëmin material kompanisë KEDS, gjykata e ka bazuar në nenin 462 të KPP-së, pasi që nga të dhënat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka vlerësuar se ka bazë të sigurt për detyrimin e të pandehurit për kompensimin e dëmit material.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 360, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, nga arsytet e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.283/2019, datë 07.03.2024**

Procesmbajtësja  
Doruntina BEKA

Gjyqtari  
Xhemajl JUSUFI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.